



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština - Municipality of Prishtina**



**KOMUNA E PRISHTINËS**

**Kryetari i Komunës**

**Nr. 01 - 037-263796, më 20-11-2015**

Në bazë të neneve 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L -040, për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", 28/15, qershor 2008), të nenit 12 dhe 13 të Vendimit për kriteret dhe procedurën e ndarjes së subvencioneve, 01. nr. 031 - 112404 të dt. 12.05.2014 dhe të nenit 52 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës më 30.10.2015, merr këtë

**V E N D I M**

- I. MIRATOHET kërkesa e INPO - Iniciativa Për Progres nga Prishtina për pagesë të mjeteve financiare për realizimin e projektit "Shkolla e Aktivizimit".
- II. Shuma e mjeteve financiare të lejuara për subvencionimin e projektit nga pika I e këtij Vendimi, do të jetë 2,000 €.
- III. Pagesa e cekur në pikën II të këtij Vendimi do të bëhet në xhironlogarinë përkatëse të INPO - Iniciativa Për Progres.
- IV. Shpenzimet e shumës së lejuar për subvencion duhet të arsyetohen përmes raportit të shpenzimeve.
- V. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtoria e Arsimit dhe Drejtoria e Financave dhe Pronës e Komunës së Prishtinës.

**A r s y e t i m**

INPO - Iniciativa Për Progres nga Prishtina i është drejtuar Drejtorisë së Arsimit të Komunës së Prishtinës për përkrahje financiare për projektin "Shkolla e Aktivizimit". Komisioni për ndarje subvencioneve ka shqyrtuar kërkesën duke gjetur se e njëjta është

kompletuar dhe se realizimi i këtij projekti është i rëndësishëm që të përkrahet financiarisht.

Kryetari i Komunës sipas propozimit të komisionit gjeti se kërkesa është e justifikuar dhe e dëshmuar me dokumentacion përcjellës duke vendosur që të lejohet pagesën e mjeteve financiare në lartësinë e përcaktuar në pikën II të diapozitivit të këtij Vendimi.

**Keshilla juridike: Kundër këtij Vendimi mund të ushtrohet ankesë me afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të saj. Ankesa ushtrohet në Ministrinë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë.**

Ju dërgohet:

- Kërkuesit,
- Drejtorisë së Financave dhe Pronës,
- Qendrës për shërbime me qytetarë.

KRYETARI I KOMUNËS  
Shpend Ahmeti

